



KUNVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

EU QENDRA

BE LAJME



korrik 2021
EUQ-numër 64/2021

KRYESIMI I SLOVENISË ME KËSHILLIN E BE-së



<https://slovenian-presidency>

Nën moton "Së bashku. Rezistent. Evropa" Sllovenia për herë të dytë kryeson me Këshillin e BE -së,

nga korriku deri në dhjetor të këtij viti. Prioritetet e Kryesisë Sllovene për gjysmën e dytë të vitit 2021 i përkasin [agjendës së re strategjike 2019-2024](#) dhe kanë për qëllim sigurimin e stabilitetit dhe zhvillimit të BE-së.

Shumica e diskutimeve në lidhje me Konferencën mbi të Ardhmen e Evropës do të zhvillohen brenda Kryesimit Slloven.

Prioritetet e kryesimit Slloven të Këshillit të BE -së:

1. Elasticiteti dhe rimëkëmbja e BE -së - Bashkimi Strategjik Autonom, zhvillimi dhe përforsimi i planeve dhe mekanizmave për forcimin e elasticitetit të BE -së në trajtimin e pandemive dhe sulmeve të mëdha kibernetike. Rimëkëmbja e BE -së nga pandemia e bazuar në tranzicionin dixhital, të gjelbër dhe tranzicion të drejtë.

2. Në kuadër të Konferencës për të Ardhmen e Evropës do të organizohen debate të hapura transparente mbi sfidat kryesore që Evropa do të duhet të adresojë në të ardhmen. Qëllimi kryesor është paraqitja e propozimeve dhe ideve nga qytetarët e BE -së se si të ndërtohet një e ardhme e përbashkët evropiane.

3. Bashkimi i mënyrës evropiane të jetesës, sundimi i të drejtës dhe kriteret e njëjta për të gjithë - Kryesimi Slloven do t'i kushtojë vëmendje respektit të barabartë për vlerat dhe parimet themelore të BE -së, përfshirë sundimin e të drejtës, i cili është përgjegjësi e përbashkët e institucioneve dhe vendeve anëtare të BE -së. Dialogu në kuadër të mekanizmit e ndjekjen e sundimit të të drejtës, duhet të bashkojë shtetet anëtare në një bashkësi të vlerave evropiane.

4. Bashkimi Evropian i besueshëm dhe i sigurt - i aftë të sigurojë siguri dhe stabilitet në fqinjësi. Qëllimi i Kryesimit Slloven është të sigurojë zbatimin efektiv të legjislacionit Shengen dhe funksionimin e

plotë të zonës Shengen pa kontrolle të kufirit të brendshëm.

Në kontekst të politikës së jashtme, Sllovenia do t'i kushtojë vëmendje të veçantë Ballkanit Perëndimor dhe në atë drejtim do të organizojë Samitin e BE-së Ballkan Perëndimor, në tetor të këtij viti në Brdo. Gjatë kryesimit, Sllovenia do të bëjë çdo përpjekje për të siguruar vazhdimin e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, në pajtim me Metodologjinë e rishikuar për Zgjerim. përforsimi i perspektivës evropiane dhe zhvillimi i qëndrueshëm i BP do të jetë një detyrë qendrore gjatë kryesimit slloven.

Qëllimi është të vazhdohet procesi i zgjerimit me theks kryesor në sundimin të të drejtës dhe zhvillimin socio-ekonomik, duke forcuar integrimin sektorial. Puna në këtë fushë do të bazohet në një instrument të ri për financimin e veprimeve të jashtme për vendet e BP dhe dokumente të tjera përkatëse të Komisionit Evropian.

Kryesia do të përpikët të miratojë përfundime pozitive të Këshillit mbi mundësitë për anëtarësim në BE.

Gjatë vjeshtës së këtij viti, Kryesimi Slloven do të fillojë procesin e miratimit formal të Instrumentit për Ndihmën e Para aderuese - IPA III.

Përmbajtja e lajmeve:

Kryesimi Slloven me Këshillin e Bashkimit	1
Në fokus të Parlamentit Evropian	2-3
Rregulla të reja për transparencën e parlamentareve gjermanë	3
Aktivitetet parlamentare në lidhje me çështjet evropiane	4-5
Raporti i BE -së për Sundimin e të drejtës	6
Qendra Hapësinore Bundestagut	6
Raporti Ekonomik Veror 2021	7
Pabarazia e tregut të punës në BE	7
Barometri i BE -së	8
Gjopa për kompanitë BMW dhe Volkswagen	8
BPV -ja e Eurozonës u rrit me 2%	9
Testimi dixhital i monedhës euro	9
Vaksinimi i popullsisë në BE	10
Prodhim i automjeteve elektrike në Spanjë	10
Orari i punës në BE	11
Kalendari i BE -së / Shtator 2021	11

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN



www.europarl.europa.eu

Në hapjen e seancës plenare, Presidenti Sasoli shprehu solidaritetin dhe ngushëllimet për viktimat e zjarreve në pyjet e Qipros.

Eurodeputetët diskutuan për aktivitetet e planifikuara të kryesimit slloven të Këshillit të BE-së me kryeministrin Janez Jansha dhe kryetaren e Komisionit Ursula fon der Lajen.

Nën sloganin "Së bashku. Elastike. Evropa". "Kryesimi Slloven do të fokusohet në rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë, duke shëndërruar synimet ambicioze të gjelbra në legjislacion detyrues, autonomi strategjike, tranzicion dixhital, sundim të së drejtës dhe mbrojtje të kufijve të jashtëm.

Parlamenti Evropian me 537 vota miratoi rregulla të përkohshme për zbulimin e abuzimit seksual të fëmijëve përmes internetit. Këto rregulla do të jenë të vlefshme për një maksimum prej tre vjetësh ose më pak nëse ndërkohë bien dakord për rregulla të reja të përhershme për trajtimin e abuzimit seksual të fëmijëve përmes internetit.

Eurodeputetët miratuan Fondin Detar, Peshkimin dhe Akuakulturën 2021-2027 për të mbështetur ekonominë blu, për të mbrojtur biodiversitetin dhe promovuar menaxhimin ndërkombëtar të oqeanëve, me vlerë 6.1 miliardë euro.

Eurodeputetët kanë miratuar një Program të përmirësuar Connecting Europe (CEF) dhe një fond të ri prej 60 miliardë eurosh për projektet e transportit, dixhitalit dhe energjisë për periudhën 2021-2027. Eurodeputetët kanë arritur të lënë mënjanë 60% të fondeve të CEF-it për projekte që do të ndihmojnë në arrijtjen e objektivave të BE-së për klimën, ndërsa 15% e fondeve për shtyllën e energjisë do të shkojnë për projektet ndërkufitare të energjisë së rinovueshme.

Në fokusin e debatit të eurodeputetëve me Presidentin e Këshillit Sharl Misheldhe Presidenten e Komisionit Ursula fon der Lajen ishte kërcënimi ndaj demokracisë dhe të drejtave themelore në disa shtete anëtare të BE -së.

Gjatë debatit mbi rezultatet e Këshillit Evropian më 24-25 qershor, shumica e folësve kritikuan ligjin e fundit të Hungarisë që ndalon materialet që mund të shihen si promovim i homoseksualitetit dhe ndryshim të seksit të të miturve.

Parlamenti Evropian jep mbështetje për krijimin e dy fondeve:

- Fondi za azil, migracija i integracija со 9,88 милијарди евра за поддршка на политиката за азил и миграција, и

- Fondi i Menaxhimit të Integruar të Kufirit me 6.24 miliardë euro për menaxhimin e kufirit të jashtëm që respekton të drejtat themelore.

Fondet do të ndihmojnë në menaxhimin e flukseve të migrimit, do të lehtësojnë integrimin e shtetasve të vendeve të treta dhe do të përmirësojnë menaxhimin e kufirit.

Në rezolutën e miratuar me 529 vota, eurodeputetët shprehën keqardhje që Komisioni kishte vendosur t'u përmbahej [konkluzioneve jo detyruese të Këshillit Evropian të Dhjetorit 2020](#) dhe të shtynte [zbatimin e rregullores së kushtëzimit të buxhetit duke zhvilluar udhëzime zbatuese.](#)

Eurodeputetët e kritikuan Komisionin për [mungesën e afatit 1 Qershor të këtij viti](#) të përcaktuar nga PE për zbatimin e rregullores dhe miratimin e udhëzimeve. Ata mirëpritën [letrën e Presidentit të PE -së të 23 qershorit](#), në të cilën thuhet se nëse Komisioni nuk vepron, PE do të ndërmarrë veprime në Gjykatën e Drejtësisë dhe shtohet se Parlamenti duhet të vazhdojë përgatitjet e tij të nevojshme sipas nenit 265 të TFEU kundër Komisionit për "mosveprim".

Parlamenti Evropian miratoi rezolutë që mirëpret regjimin e BE -së për sanksionet globale të të drejtave të njeriut, ndërsa bën thirrje që korrupsioni të përfshihet si vepër penale. Eurodeputetët duhet të jenë në gjendje të propozojnë raste të shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut në mënyrë që të rrisin legjitimitetin e regjimit të sanksioneve. Ata këmbëngulin në një proces gjithëpërfshirës edhe për shoqërinë civile.

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Parlamenti Evropian ka miratuar qëndrimin e tij për negociatat me Këshillin, për të zgjatur mandatin e Agjencisë Evropiane të Barnave dhe për të forcuar rolin e saj. Eurodeputetët bënë thirrje për krijimin e një baze dixhitale ndërvepruese të BE -së që synon zbulimin, parashikimin dhe parandalimin e mungesave të ilaçeve. Baza e të dhënave e re duhet të lehtësojë përgjithmonë aksesin dhe shkëmbimin e informacionit midis Agjencisë dhe autoriteteve përkatëse nacionale.

Negociatat për formimin e dy të ashtuquajturave zonat e Mbrojtura Detare Antarktike (MPA) janë lënë në pritje. Në projekt-rezolutën e miratuar, eurodeputetët theksuan urgjencën e arritjes së një marrëveshjeje midis palëve negociuese brenda Komisionit për Ruajtjen e Burimeve të Gjalla Detare Antarktike.

Në rezolutë e miratuar me 603 vota, eurodeputetët dënuan ashpër aktakuzën e ngritur nga kryeprokurori publik i Turqisë në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shpërbërjen e Partisë Demokratike të Popullore HDP, partia e tretë më e madhe politike në Turqi dhe një ndalim politik për gati 500 anëtarë HDP.

Në seancën plenare, Parlamenti Evropian miratoi tre rezoluta për situatën e të drejtave të njeriut në Hong Kong, Arabinë Saudite dhe Iran.



www.europarl.europa.eu

RREGULLA TË REJA PËR TRANSPARENCË E PARLAMENTARVE GJERMAN

Fondacioni "Oto Brener" i cili është pranë sindikatave, vlerësoi të dhënat mbi fitimet shtesë të anëtarëve të Bundestagut bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht në faqen e internetit të parlamentit gjerman.

vlerësohet se deputetët në Bundestag kanë fituar 53 milionë euro të ardhura shtesë në mandatin aktual, që është dukshëm më i lartë se më parë. Fondacioni e kreu këtë studim në 2009 me të dhëna për periudhat aktuale dhe dy periudhat e mëparshme.

Në mandatin aktual që po përfundon së shpejti, rreth 1/3 e parlamentarëve, më saktësisht 261, kishin angazhime përmes të cilave ata arritën të ardhura shtesë.

Edhe pse FDP Liberale në Bundestag ka 11.5% të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ata janë në vendin e parë midis atyre që marrin të ardhura shtesë me një pjesë prej 20.3%.

Angazhimet shtesë të deputetëve, krahas mandatit të tyre në Bundestag, lejohen ligjërisht për sa kohë që nuk ka konflikt interesi dhe përderisa angazhimi parlamentar është në zemër të aktivitetëve të tyre.

Të ardhurat nga ky lloj angazhimi mbi një shumë të caktuar duhet të raportohen në Presidencën e Bundestagut dhe të publikohen në faqen e internetit të Bundestagut si "informacion që duhet të vihet në dispozicion të publikut".

Deri tani, të ardhurat shtesë të parlamentarëve duhej të raportoheshin nëse tejkalojnë 1.000 euro në muaj ose 10.000 në vit. Të ardhurat mbi 250,000 euro nuk ka pse të renditen në mënyrë më të detajuar dhe i përkasin të njëjtit grup me ata shumat e të cilëve janë në miliona.



Pas një skandali që përfshin marrëveshje fitimprurëse mbi blerjen e maskave mbrojtëse dhe lobimin me pagesë për politikanët, Bundestagu miratoi rregulla më të rrepta të transparencës për parlamentarët në mes të qershorit.

Fondacioni Oto Brener në studimin i përfshin të dhënat në studim deri më 1 qershor të këtij viti, përkatësisht para se rregullat e reja të hyjnë në fuqi.

Sipas rregullave të reja, të ardhurat shtesë duhet të raportohen në të ardhmen nëse tejkalojnë 1.000 euro në muaj ose 3.000 euro gjatë vitit. Gjithashtu është parashikuar që shumat e saktë e atyre të ardhurave të shpallet - "çdo euro dhe cent".

Fondacioni bën thirrje për shtrëngim të mëtejshëm të këtyre rregulloreve. Autori i studimit, Sven Osterberg, bëri thirrje për një komision "që do të kishte burime dhe të drejta dhe do të monitoronte pajtueshmërinë".

<https://gettotext.com>
<https://www.bundestag.de>

AKTIVITETE TË KUVENDIT NË LIUDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Më 30 korrik 2021, Talat Xhaferi u takua me eurodeputetin Christian Sagartz, raportues në hije për Maqedoninë e Veriut nga Partia Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian, i cili ishte në vizitën e tij të parë dy-ditore të punës në vend.

Në takim, Xhaferi theksoi se Kuvendi është gati për të gjitha hapat e ardhshëm që e presin vendin në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Ai paraqiti shpresën se vizita e eurodeputetit Sagartz do të jetë një mundësi e mirë për të njoftuar eurodeputetin me situatën aktuale dhe gatishmërinë e vendit për të filluar negociatat bazuar në kriteret e përmbushura dhe meritat.

Kryetari i Këshillit Kombëtar për Eurointegritet Aleksandar Nikollovski, bashkë-kryesuesi i Komitetit të Përbashkët Parlamentar BE-Republika e Maqedonisë së Veriut Bilal Kasami dhe kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane Arbër Ademi gjithashtu patën takime të ndara me eurodeputetin Sagartz.



Më 26 korrik 2021, kryetari Xhaferi u takua me Benedetto Della Vedova, zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Republikës Italiane. Në takim, Xhaferi falënderoi mbështetjen e Parlamentit Italian, i cili me rezolutat e miratuara i jep mbështetje të sigurtë dhe pa mëdyshje integritetit tonë evropian. Bashkëbiseduesit riafirmuan rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm politik në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi i përgjithshëm dypalësh midis dy vendeve.



Kryetari Xhaferi iu drejtua Forumit të Prespës për dialog që u mbajt më 1 korrik 2021 në Ohër. Në fjalën e tij, Xhaferi theksoi se Marrëveshja e Prespës tregoi gatishmërinë për bashkëpunim konstruktiv me fqinjët, riafirmoi shtetësinë e vendit në Kombet e Bashkuara dhe i mundësoi vendit të bëhet anëtar i plotfuqishëm i NATO -s.



Më 21 korrik të këtij viti, kryetari Xhaferi mori pjesë në një diskutim mbi Strategjinë e Politikës së Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut - "Reflektim 2030", në mënyrë që të theksohet rëndësia dhe domethënia e dimensionit parlamentar dhe roli kryesor i Kuvendit në përgatitjen e Strategjisë. Në fjalimin e tij, Xhaferi theksoi rëndësinë e diplomacisë parlamentare, prioritetet strategjike të Kuvendit në planin ndërkombëtar dhe segmentet kryesore të politikës së jashtme me angazhimin proaktiv të komisioneve parlamentare, delegacioneve dhe grupeve të bashkëpunimit.

AKTIVITETE TË KUVENDIT NË LIUDHJE ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Këshilli Kombëtar për Euro-integrime dhe Komiteti për Çështje Evropiane më 15 korrik 2021 mbajtën sesion të përbashkët në të cilin Ambasadori Slloven, shkëlqesia e tij Milan Predan prezantoi Programin dhe prioritetet për punën e Presidencës Sllovene me Këshillin e Bashkimit Evropian për periudhën korrik - dhjetor 2021. Kryetari i KSHNEI dhe KÇE, Aleksandar Nikolovski dhe Arbër Ademi, përshëndetën presidencën e Sllovenisë dhe angazhimin e saj për zgjerimin e BE-së. Komisioni për Politikë të Jashtme dhe MPK EU-RMV ishin gjithashtu të ftuar në sesion.



www.sobranie.mk



Më 8 korrik 2021, kryetari Xhaferi kishte fjalim në ngjarjen promovuese të projektit të binjakëzimit IPA për "Përmirësimin e revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrjes parlamentare", i cili u mbajt në Delegacionin e BE -së në vendin tonë. Xhaferi tha se në kuadër të projektit të parë të binjakëzimit për përf forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe Entit Shtetëror të Revizionit, u realizuan dy vizita studimore të deputetëve dhe shërbimit të Kuvendit në parlamentet e Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Bullgarisë.

Kryetari i Komitetit për Çështje Evropiane, Arbër Ademi, më 19 korrik 2021, mori pjesë në Video Konferencën të Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare për Çështje Evropiane të Shteteve Anëtare të BE -së (COSAC). Në fjalimin e tij në sesionin e parë të konferencës, Ademi theksoi rëndësinë e procesit të bashkimit me vendet candidate për anëtarësim në BE, si një proces i rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ademi përshëndeti angazhimin e presidencës sllovene në politikën e zgjerimit të BE -së dhe të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në BE.



Kryetari i Grupit Parlamentar për Bashkëpunim me Parlamentin e Republikës së Austrisë, Arbër Ademi, më 12 korrik 2021 pati video takim me Kryetaren e Grupit për Bashkëpunim midis Austrisë dhe Maqedonisë së Veriut në Këshillin Kombëtar të Republikës së Austrisë, Stephanie Crisper. Në takim, bashkëbiseduesit shkëmbyen informacion mbi ngjarjet aktuale në dy dhomat ligjvënese, situatën me pandeminë dhe procesin e vaksinimit.

Në qershor 2021, Komisioni për Çështje Evropiane mbajti 5 mbledhje në të cilat u shqyrtuan 5 ligje.



Komiteti për Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive në seancë solemne më 29 korrik 2021 shënoi 20 vjetorin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ku fjalim pati edhe Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi. Themelimi i Komitetit në 2002 ishte mënyra më e përshtatshme për të shqyrtuar çështjet e bashkësive etnike në vendin tonë, marrëdhënia reciproke e të cilëve ishte një pengesë për rritjen dhe zhvillimin e vendit, tha Xhaferi. Kryetarja e Komitetit, Arbana Pasholi dhe Zëvendëskryeministri i Parë dhe Ministër për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, gjithashtu kishin fjalime.

RAPORT MBI SUNDIMIN E LIGJIT NË BASHKIMIN EVROPIAN



Komisioni Evropian më 20 korrik 2021. paraqiti [Raportin e dytë](#) mbi sundimin e ligjit në BE me Komunikimin mbi situatën në BE në tërësi dhe veç e veç sipas [kapitujve](#) për secilin shtet anëtar. Në Raportin për vitin 2021 shqyrtohen zhvillimet e reja nga shtatori 2020, duke thelluar vlerësimin e çështjeve të identifikuara në raportin e mëparshëm dhe duke marrë parasysh ndikimin e pandemisë Kovid-19. Raporti konfirmon shqetësimet në disa shtete anëtare në lidhje me përparësinë e të drejtës evropiane, pavarësinë e gjyqësorit dhe lirinë e medias.

Gjetjet kryesore mbi gjendjen e sundimit të ligjit në vendet anëtare

Raporti i vitit 2021 bazohet në metodologjinë dhe fushëveprimin e raportit të mëparshëm, duke u fokusuar në katër elementë kryesorë: sistemet e drejtësisë; kuadri kundër korrupsionit; pluralizmi i medias dhe liria e medias; dhe çështje të tjera institucionale që lidhen me kontrollin dhe ekuilibrin institucional.

1 Sistemet juridike - Në shumë shtete anëtare, po ndërmerren hapa për të forcuar pavarësinë gjyqësore. Disa vende anëtare kanë vazhduar të zbatojnë reforma që zvogëlojnë garancitë e tyre të pavarësisë gjyqësore si rezultat i rritjes së ndikimit të ekzekutivit dhe legjislativit në funksionimin e sistemit të tyre gjyqësor.

2 Kuadri kundër korrupsionit - Shumica e vendeve anëtare të BE -së kanë ndërmarrë hapa për të

forcuar kuadrin për parandalimin e korrupsionit dhe integritetit, përfshirë rregullat e konfliktit të interesit. Sfidat mbeten në lidhje me hetimet penale, ndjekjet penale dhe vendosjen e sanksioneve ndaj korrupsionit në disa shtete anëtare. Rastet e mëdha ose shumë komplekse të korrupsionit kanë vazhduar të ndodhin në vende të ndryshme anëtare.

3 Liria e medias dhe pluralizmi - [Monitoruesi i Pluralizmit të Medias 2021](#), një burim kyç i informacionit për Raportin e Sundimit të Ligjit - tregon një përkeqësim të përgjithshëm të situatës së gazetarëve në disa vende anëtare. Jo të gjithë rregullatorët e medias janë të lirë nga ndikimi politik dhe ekziston një rrezik i lartë i ndërhyrjes politike në media në disa vende anëtare. Pandemia Kovid-19 ka shkaktuar gjithashtu sfida serioze ekonomike për sektorin e medias, duke bërë që disa vende anëtare të miratojnë skema për të mbështetur shtëpitë e mediave.

4 Kontrolli dhe balanca institucionale - Zhvillimet e shumta kanë ngritur shqetësime në lidhje me respektimin e parësisë së ligjit të BE -së, thelbësor për funksionimin e rendit juridik të BE -së dhe barazinë e vendeve anëtare. Shoqëria civile në disa vende anëtare ka vazhduar të përballet me sfida serioze, të tilla si kërcënime të qëllimshme nga autoritetet, mbrojtje joadekuate kundër sulmeve fizike ose verbale, ose nivele të papërshtatshme të mbrojtjes së të drejtave themelore që garantojnë punën e tyre.

Raporti vjetor i sundimit të ligjit është rezultat i një dialogu të ngushtë me autoritetet kombëtare dhe palët e interesuara. Ai mbulon të gjitha vendet anëtare në baza objektive dhe të paanshme. Vlerësimi cilësor i kryer nga Komisioni fokusohet në zhvillimet e rëndësishme që nga miratimi i raportit të parë vjetor të sundimit të ligjit dhe siguron një qasje koherente duke përdorur të njëjtën metodologji për të gjitha vendet anëtare, ndërsa qëndron proporcionale me zhvillimin. Shtrirja dhe metodologjia e edicionit 2021 janë të njëjta si për raportin e parë vjetor të sundimit të ligjit, të miratuar në shtator 2020.

<https://ec.europa.eu>

QENDRA HAPËSINORE E BUNDESVER



Forcat e Armatosura Gjermane më 13 korrik 2021. lëshuan në përdorim qendër hapësinore të vendosur në bazën në provincën e Rajnës Veriore - Uestfali. "Hapësira është bërë një infrastrukturë kritike që duhet të mbrohet" deklaroi Ministria e Mbrojtjes Annegret Kramp Karenbauer në ceremoninë e hapjes së qendrës. Detyra kryesore e qendrës hapësinore do të jetë mbrojtja e gjashtë satelitëve ushtarakë gjermanë në orbitë, monitorimi i mbeturinave të hapësirës dhe analizimi i aktiviteteve zbuluese në hapësirë, raporto i Deutsche Welle. Rreth 80 njerëz janë angazhuar në aktivitetet e qendrës hapësinore, dhe numri i tyre duhet të

rritet në 250.


RAPORT VJETOR EKONOMIK 2021

Raporti i Komisionit Evropian mbi perspektivat ekonomike në BE dhe Eurozonë parashikon rritje prej 4,5% për 2022, që është një normë më e lartë se sa ishte parashikuar fillimisht.

Sipas raportit të rregullt ekonomik veror të Komisionit, ekonomia e BE -së do të rritet me 4,8% këtë vit dhe 4,5% në 2022, që është 0,6% më shumë për 2021 sesa llogaritet nga shërbimet e KE-së. Disa faktorë do të kontribuojnë në këtë skenar ekonomik optimist: së pari, vaksinimi po bën përparim të mirë dhe ka çuar në një ulje të përqindjeve të të infektuarve të rinj dhe të shtruar në spital. Hapja e aktivitetit ekonomik në vendet

e BE -së ka ndihmuar sektorin e biznesit, shpjegon KE. Konsumatorët kanë treguar shkallë të kënaqshme besimi dhe dëshirë për konsum, dhe KE është e kënaqur me faktin se turizmi i brendshëm në BE po tregon shenja përmirësimi, veçanërisht me prezantimin e Kovid Certifikatës së re për Udhëtim.

Komisioni Evropian është i bindur se Fondi për Rimëkëmbje do të kontribuojë në "rritje të konsiderueshme" në ekonominë e BE -së. Mbetet që inflacioni gjithashtu duhet të jetë më i lartë se sa ishte planifikuar këtë vit dhe vitin e ardhshëm për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, ndër të tjera, por edhe për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të prodhimit dhe lëndëve të para të pamjaftueshme. Inflacioni duhet të arrijë 2,2% këtë vit, dhe 1,6% vitin tjetër në BE.



<https://ec.europa.eu/>

PABARAZIA NË TREGUN E PUNËS NË BE

Raporti i fundit i Komisionit Evropian mbi zhvillimin social në BE analizon pasojat e krizës shëndetësore dhe paralajmëron vendet që të jenë të kujdesshme ndaj thellimit të pabarazive.

Sipas raportit, rritja më e madhe e papunësisë është në vendet e punës - furrat e bukës, ato që kërkojnë prani fizike siç është sektori i ushqimit ose turizmi. Më pak të prekura nga kriza janë punët që janë kritike, por edhe ato që kërkojnë një shkallë të ulët të ndërveprimit social dhe që mund të punohen nga shtëpia, kryesisht në informatikë, sigurime dhe telekomunikacion. Sektori i shëndetësisë është më kritikuar gjatë krizës.

Komisioni Evropian vëren në analizën e tij se pasojat gjeografike të krizës Kovid-19 tregojnë gjithashtu dallime të rëndësishme, kështu që shumica e vendeve të punës janë humbur në zonat rurale, ndërsa vendet anëtare të BE -së në jug, të cilat janë më të varura nga turizmi, janë gjithashtu, më të prekura se të tjerët.

Kriza ka pasur gjithashtu një ndikim në dialogun social dhe marrëveshjet kolektive të punëtorëve, por përsëri me dallime të rëndësishme midis vendeve anëtare. Për shkak të nevojës për 'ndërhyrje urgjente' nga shteti ose për arsye shëndetësore, disa vende e kanë kufizuar mundësinë e negociatave kolektive.



Për sa i përket dallimeve gjinore, burrat janë pak më të prekur se gratë kur bëhet fjalë për vendet e punës, por gratë kanë përjetuar një rënie serioze të orëve të punës, veçanërisht në semestrin e dytë të vitit 2020.

Komisionari i BE -së për të Drejtat Sociale Nicholas Schmidt tha se politikat e rimëkëmbjes ekonomike duhet të marrin parasysh gjetjet e këtij raporti për të mundësuar një tranzicion më të drejtë.

<https://www.eurofound.europa.eu>

BE BAROMETËR



Sipas Eurobarometrit të fundit, për qytetarët e BE -së problemi më serioz me të cilin përballet aktualisht bota janë ndryshimet klimatike. Rreth 93% e evropianëve të anketuar thanë se ndryshimi i klimës ishte një problem serioz, 78% thanë se ishte "shumë serioz" dhe vetëm 4% janë deklaruar për ndotjen. Shumica dërmuese e qytetarëve të BE -së (90%) presin që politikanët e tyre të marrin vendime

konkrete për të zvogëluar emetimet e gazrave serrë, ndërsa 87% besojnë se BE -ja duhet të vendosë synime ambicioze për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe për të përmirësuar efikasitetin e energjisë.

Shumica e qytetarëve thanë se tashmë po merren masa individuale për të parandaluar ndryshimet klimatike, por gjithashtu u përgjigjën se nevojiten ndryshime strukturore globale.


Qytetarët së pari presin që të ndërmerren hapa konkretë nga qeveritë, pasuar nga bizneset private dhe më pas BE.

Rreth 81% e qytetarëve të BE -së besojnë se burimet e pastra të energjisë duhet të marrin subvencione më të larta nga vendet.

Për Kryetarin Ekzekutiv të Paktit të Evropës së Gjelbër, François Timmermans, rezultatet e këtij Eurobarometri janë dëshmi se pavarësisht nga pandemia dhe vështirësitë ekonomike, qytetarët evropianë janë të vetëdijshëm për rreziqet afatgjata të paraqitura nga ndryshimet klimatike dhe presin nga qeveritë, si dhe sektori privat të ndërmarrin masa konkrete.

<https://europa.eu/eurobarometer/>

GJOBA PËR KOMPANITË BMW DHE FOLKSVAGE



Komisioni Evropian ka gjobitur prodhuesit gjermanë të makinave Volkswagen dhe BMW me një total prej 875 milion euro për shkak të bashkimit me një kartel që synon parandalimin e konkurrencës në teknologjinë e pastrimit të oksidit të nitrogjenit nga gazrat e dizel motorëve.

Karteli përfshinte pesë prodhues makinash: "Daimler", që prodhon Mercedes, BMW dhe Volkswagen, Audi dhe Porsche, të cilët janë pjesë e Grupit Volkswagen.

"Daimler" zbuloi ekzistencën e kartelit para Komisionit dhe u lirua plotësisht nga gjoba. "Volkswagen" u gjobit me 502 milionë euro, dhe "BMW" me 373 milionë euro.

Pesë prodhuesit kanë një teknologji të quajtur Sistemet e Reduktimit Seleksionues të Katalizës (SCR), e cila pastron gazrat e shkarkimit duke shtuar ure të lëngshme në sistemin e shkarkimit, të quajtur "AdBlue", i cili konverton oksidin nitrik në ujë dhe azot të padëmshëm. Kjo ndodh vetëm nëse shtohet mjaftueshëm nga ai "lëng blu". Problemi është se prodhuesit me marrëveshje reciproke kanë zvogëluar emetimet e materieve të dëmshme vetëm për të përbushur normat minimale ligjore, megjithëse ata kanë teknologjinë që lejon reduktime të konsiderueshme. Me këtë marrëveshje, ata eliminuan kërcënimin se konkurrentët e tyre do të ishin më të mirë. Daimler, BMW, Volkswagen, Porsche dhe Audi kanë mbajtur takime të rregullta teknike gjatë pesë viteve të fundit për të zhvilluar së bashku sistemet e makinave të pasagjerëve me naftë SCR sisteme që plotësojnë kërkesat rregullatore të BE -së.

Që në vitin 2007, BE-ja prezantoi standardet minimale për emetimet e oksidit të nitrogjenit (të ashtuquajturat standarde "Euro 5" dhe "Euro 6"), të cilat kanë qenë në fuqi që nga viti 2009. Kjo është hera e parë që Komisioni ka penalizuar shoqërim të bazuar në kartel dhe jo për përcaktimin e çmimeve ose ndarjen e tregut.

BPV NQ EUROZONË U RRIË PËR 2%

Sipas vlerësimit të parë të Shërbimit Statistikor të BE - së, të publikuar më 30 korrik të këtij viti, bruto produkti vendor (BPV) i Eurozonës u rrit me 2% në periudhën nga prilli deri në qershor në krahasim me tremujorin e parë të këtij viti. Aktivitetet ekonomike në fushën e monedhës së vetme të euros u rritën me 13,7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, sipas Eurostat.

Në fillim të vitit 2020, pati një rënie të mprehtë të BPV-së pasi vendet mbyllën kufijtë e tyre në përgjigje të pandemisë me Kovid-19. Në tremujorin e dytë të vitit 2020, është vërejtur rënie më e madhe që nga fillimi i regjistrimeve të Eurostat në 1995. Me mbylljen e vendeve të euroblokut, ekonomia u fundos me më shumë se 11% në eurozonë dhe BE.

Këtë vit, perspektiva ekonomike është më pozitive. Në BE, PBB -ja u rrit me 1,9% në tremujorin e dytë të këtij viti, dhe me 13,2% në baza vjetore, sipas Eurostat. Ndër shtetet anëtare për të cilat disponohen të dhëna për tremujorin e dytë të vitit 2021, Portugalia (+ 4,9%) regjistroi rritjen më të madhe në krahasim me tremujorin e mëparshëm, pasuar nga Austria (+ 4,3%) dhe Letonia (+ 3,7%). Rritja më e ulët u regjistrua në Lituanin (+ 0,4%) dhe Republikën Çeke (+ 0,6%).

Në një vlerësim të veçantë të Eurostat, inflacioni në eurozonë pritet të rritet me 2,2% në korrik krahasuar



eurostat

me 1,9% në qershor. Rritja e inflacionit është për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë me 14,1% në korrik në krahasim me vitin e kaluar.

Inflacioni mund të arrijë deri në 3% deri në fund të vitit. Politikëbërësit e BQE-së kanë paralajmëruar tashmë për një kërcim të përkohshëm të inflacionit, duke thënë se ata nuk do ta rregullojnë politikën pasi faktorët e njehershëm të rritjes, siç janë çmimet më të larta të naftës, ka të ngjarë të zhduken vitin e ardhshëm.

Agjencia publikoi se niveli i papunësisë në eurozonë ra në 7,7% në qershor, nga 8% një muaj më parë. Në BE, norma ra në 7,1%, nga 7,3% në maj.

TESTIMI I EUROVALUTËS DIGJITALE

Organi drejtues i Bankës Qendrore Evropiane (BQE) më 14.07.2021 tha se kishte nisur një "fazë kërkimore" mbi një projekt 24-mujor të monedhës digjitale të euros që mbulonte projektimin dhe shpërndarjen e eurovalutës.

Presidentja e BQE -së, Christine Lagarde theksoi se qëllimi i BQE -së "është të sigurojë që qytetarët dhe bizneset në epokën digjitale të kenë qasje në formën më të sigurt të parave, paratë e bankës qendrore", shtoi Lagarde.

Qëllimi i testit është të adresojë nevojat e konsumatorëve në mënyrë që të krijojë një "formë të përballueshme dhe efektive të parave digjitale për bankën qendrore", duke shmangur kështu rreziqet për qytetarët e eurozonës dhe duke mbrojtur privatësinë e tyre, si dhe ndikimin e tyre potencial digjital të euros në treg dhe ekonominë si tërësi.

<https://www.ecb.europa.eu>



VAKSINIMI I POPULLSISË NË BE



Kryetarja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen më 27 korrik 2021, tha se është arritur qëllimi i Komisionit për "administrimin e të paktën dozës së parë të vaksinës në 70% të popullsisë së rritur në BE deri në korrik". Sipas të dhënave të fundit nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), 84% e të rriturve kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës në Maltë, e cila ka shkallën më të lartë të vaksinimit.

Vijojnë Danimarka me 83,7%, Holanda 83,5%, Belgjika 82,7% dhe Finlanda me 78,9%.

Shkalla më e ulët e vaksinimit u regjistrua në Bullgari 18,5%, e ndjekur nga Rumania 31,1%, Letonia 44%, Kroacia me 47%, Sllovakia 47,9% dhe Sllovenia me 49,7%.

Vaksinimi, i cili filloi në ditët e para të 2021 në vendet e BE-së, ka përparuar ngadalë në muajt e parë, duke bërë që administrata e BE-së, të kritikohet.

Kryetari i Komisionit Evropian bëri thirrje për vazhdimin e përpjekjeve për vaksinim, kryesisht për shkak të përhapjes së llojit delta të virusit.

Varianti Delta pritet të bëhet [lloj mbizotërues në nivel global](#) në muajt e ardhshëm dhe tashmë është identifikuar në pothuajse të gjitha vendet evropiane. Midis 28 qershorit dhe 11 korrikut të këtij viti, [varianti ishte dominues](#) në 19 vende në Evropë, që përbëjnë një mesatare prej 68,3% të rasteve.

Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) deri më tani ka miratuar përdorimin e katër vaksinave të koronavirusit, ato nga BayonTech-Pfizer, Moderna, AstraZeneka dhe Johnson & Johnson.

EMA vazhdon me vlerësimet paraprake të vaksinave "Sinovak", "Kurvak", "Sputnik V", "Novavax", dhe "Sanofi Pasteur".

PRODHIMI I AUTOMJETEVE ELEKTRIKE NË SPANJË



Spanja do të investojë 4,3 miliardë euro në prodhimin e automjeteve elektrike dhe baterive si pjesë e një programi të madh kombëtar të financuar kryesisht nga Fondi i BE -së për Rindërtimin, tha qeveria spanjolle. Kryeministri Pedro Sanchez në prezantimin tha se plani i qeverisë ka për qëllim inkurajimin e investimeve private, do të mbulojë të gjithë zinxhirin e prodhimit, nga minierat e litiumit deri në montimin e baterive. Sektori privat, sipas vlerësimeve të qeverisë, mund të kontribuojë me 15 miliardë euro shtesë.

Pas Gjermanisë, Spanja është vendi i dytë më i madh si prodhues evropian i makinave dhe i teti në botë. Programi i ri i investimeve, i cili është pjesë e një pakete prej 13

miliardë eurosh që synon lëvizshmëri të qëndrueshme, pritet që kontributi i sektorit në prodhimin ekonomik të arrijë në 15% deri në vitin 2030, nga 10% aktual. Programi do të përfshijë 1 miliard euro për të forcuar infrastrukturën për karikimin e makinave elektrike.

Si një nga përfituesit kryesorë të programit të rimëkëmbjes të BE-së prej 750 miliardë euro, Spanja do të marrë grante prej rreth 70 miliardë euro deri në vitin 2026 për të ndihmuar në ringjalljen e ekonomisë së goditur nga pandemia.

<https://www.euroweeklynews.com>

ORARI I PUNËS NË BASHKIMIN EVROPIAN

Sipas të dhënave të Eurostat, numri i orëve të punës në BE është zvogëluar për 12% krahasuar me një vit më parë. Sipas agjencisë, rënia mund të shpjegohet me masat e ndërmarra në përgjigje të pandemisë Kovid-19 që detyroi qindra njerëz të ishin në pushim të paguar dhe të papaguar nga puna. Si rezultat, orët e punës realizohen dukshëm më pak.


Rënia më e madhe u regjistrua në Greqi (-19.7 përqind), Spanjë (-19.5%), Portugali dhe Itali (-19%secila), dhe Bullgaria është në vendin e 16-të me një rënie prej 10%. Vendet e BE-së, me ndryshim të lehtë në orarin e punës (më pak se 5%) janë Finlanda (-4.4%), Danimarka dhe Luksemburgu (2%secila).

Një total prej 26,9 milion njerëz në BE raportuan se punonin më pak se zakonisht gjatë vitit 2020. Për krahasim, në vitin 2019 ai numër ishte 24,4 milion njerëz. Numri i njerëzve që punojnë jashtë orarit është ulur nga 7,3 milion në 2019 në 5,8 milion në 2020.

Numri i atyre që punuan më shumë për shkak të orëve të ndryshueshme ra me 1 milion në 4,7 milion, dhe numri i atyre që punuan më shumë për arsye të tjera u ul me 0,5 milion në 2,3 milion.

<https://ec.europa.eu/>

[eurostat](https://ec.europa.eu/eurostat)



ec.europa.eu/eurostat

LIGJET E MIRATUAR NË KUVEND NË MUAJIN KORRIK 2021

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimet publike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë,
- Ligji për menaxhimin e baterive dhe akumulatorëve dhe mbetjeve nga bateritë dhe akumulatorët,
- Ligji për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike,
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, me procedurë të shkurtuar,
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zhvillim të balancuar rajonal, me procedurë të shkurtuar.



BE KALENDAR / shtator 2021

- 1 Sesioni Plenar i Parlamentit Evropian, 13-16/09/2021, Strasburg;
- 2 Konferencë për Siguri Kibernetike, 02-03 / 09/2021;
- 3 Mbledhja e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, 21/09/2021, Bruksel,

European Union Newsroom

europa.eu

[Home](#)
[Highlights](#)
[Press releases](#)
[Calendar](#)
[Audiovisual](#)
[Press contacts](#)
[Press facilities](#)
[Subscription services](#)
[About the EU](#)

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

September

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

Lidhje të dobishme për publikimet elektronike të BE -së:

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 tetori p.n. 10, Shkup, 1000

telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvend u zbatuar Projekti IPA për "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 deri në qershor 2012, qëllimi i përgjithshëm i të cilit ishte forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe me këtë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së tij ndaj qytetarëve.

Në kuadër të projektit IPA, u siguroa ndihmë financiare dhe profesionale për krijimin e BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të Qendrës së BE -së është t'u sigurojë deputetëve në Kuvend dhe Shërbimit qasje më të mirë në informacion mbi çështjet e BE -së.

BE Qendra si pjesë organizative është në përbërje të Sektorit për Mbështetjes të Këshillit Nacional për Eurointegritime.

